



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
  
Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L-110 dt.31.05.2012, nenit 21, 22, & 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 dt.21.07.2016, nenit 17 pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L - 040, dt. 20.02.2008, nenit 15, pika “d”, i Statutit të Komunës së Prishtinës, Nr.110-391 dt.25.02.2010, Udhëzim Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 01nr.031 – 185481 dt.14.08.20215, dhe duke vendosur sipas kërkesës për kushte ndërtimore, 05nr.350/02-147747/25 dt.26.09.2025 (sipas eLeja KKN-611), të kërkuësve: Pronarëve, Ismajl Hyseni, Idriz Selmani, Etnik dhe Arbër Hajdini nga Prishtina dhe “Alb Petrol” sh.p.k. nga Podujeva, me Investitor “Alb Petrol” sh.p.k. nga Podujeva, rr. “Halil Breznica”, pn, në Podujevë, me ARBK 812050657, dhe me pronar / përfaqësues Idriz Ejupi nga Podujeva, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – **Ndërtesa, “1” me 2B+S+P+12 (me aplikim të “Arkitekturë e qëndrueshme”)**, në kuadër të Bllokut urban “F-5”, Tërësia urbane “F”, të Planit Rregullues “Prishtina Re - Zona Përendim” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt për vendosjen e çështjes administrative, me datë, 02.04.2026, merr këtë:

**V E N D I M**  
**CAKTIMI I KUSHTEVE NDËRTIMORE**

**I. I caktohen kushtet ndërtimore** kërkuësve: Pronarëve, Ismajl Hyseni, Idriz Selmani, Etnik dhe Arbër Hajdini nga Prishtina dhe “Alb Petrol” sh.p.k. nga Podujeva, me Investitor “Alb Petrol” sh.p.k. nga Podujeva, rr. “Halil Breznica”, pn, në Podujevë, me ARBK 812050657, dhe me pronar / përfaqësues Idriz Ejupi nga Podujeva, sipas kërkesës 05nr.350/02-147747/25 dt.26.09.2025 (sipas eLeja KKN-611), për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste – **Ndërtesa, “1” me 2B+S+P+12 (me aplikim të “Arkitekturë e qëndrueshme”)**, në kuadër të Bllokut urban “F-5”, Tërësia urbane “F”, të Planit Rregullues “Prishtina Re - Zona Perëndim” në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale, **nr.355-5, 6, 7 & 8 ZK Çagllavicë**, si dhe me trajtim përmes transferit të pjesës së parcelës kadastrale **nr.424-41 ZK Çagllavicë**, me pronar / posedues “ALB Petrol” sh.p.k. nga Podujeva, sipas projekt propozimit konceptual & Plani i situacionit – “zgjidhja urbane” të prezantuar.

**II. Lokacioni** i parcelave kadastrale për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01nr.035-186861 dt.02.10.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është paraparë të jetë me destinim “miks”.

Për parametrat, kriteret urbane dhe kushtet e ndërtimit të planit rregullues, kërkuësit janë informuar përmes faqes zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës.

**III. Gjendja ekzistuese** e lokacionit/parcelave kadastrale, **nr.355-5, 6, 7 & 8 & nr.424 – 41 ZK Çagllavicë**, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelave kadastrale, janë:
  - nr.355-5; S=500m<sup>2</sup>; Etnik dhe Arbër Hajdini.....“Arë e klasës 5”;
  - nr.355-6; S=500m<sup>2</sup>; Idriz Selmani;.....“Arë e klasës 5”;
  - nr.355-7; S=500m<sup>2</sup>; Ismajl Hyseni;.....“Arë e klasës 5”;
  - nr.355-8; S=500m<sup>2</sup>; Ismajl Hyseni;.....“Arë e klasës 5”;
  - Totali: S=2,000m<sup>2</sup>;**
  - nr.424-41; S=307m<sup>2</sup>; “Alb Petrol” sh.p.k.;.....“Arë e klasës 6”;
  - Totali: S=2,000 + 307=2,307m<sup>2</sup>;**
- E drejta pronësore - juridike e parcelave kadastrale të lartcekura, është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;

- Në kuadër të parcelave të lartcekura, përfshihet një ndërtesë afariste, me etazhitet P+2;
- Terreni ka pjerrtësi në drejtimin verilindje-jugperëndim, me disnivel ~4.00m’;
- Qasja ekzistuese e parcelave të lartcekura është përmes rrugës të planifikuar dhe ekzistuese, bazuar në Plani i situacionit – “zgjidhja urbane” të kompleksit;
- Pjesa e parcelës kadastrale **nr.424–41 ZK Çagllavicë**, me sipërfaqe  $S=123m^2$ , dhe me pronar “Alb Petrol” sh.p.k. nga Podujeve, e cila përfshihet në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina Re - Zona Përendim” në Prishtinë me destinim rrugë e planifikuar e planit, është propozuar nga pronari dhe investitori, të trajtohet përmes transferit të saj, në kuadër të Bllokut urban “F-5” të planit të njëjtë;
- Me shkresën zyrtare “Pëlqim për Arkitekturë të qëndrueshme” 05nr.352/10–37578/26 dt.01.04.2026, lëshuar nga Sektori i Mjedisit dhe i Efiqencës i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, është dhenë pëlqim në elaboratin për “Arkitekturë e qëndrueshme”;
- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50m` ka ndërtime - shtëpi banimi dhe komplekse banesore.

**IV. Plani i situacionit** – “zgjidhja urbane” për kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa, “1”** me 2B+S+P+12 (*me aplikim të “Arkitekturë e qëndrueshme”*) & **“2”** me 2B+S+P+10, është konceptuar të zhvillohet në dy faza të realizimit: Faza “1”, & “2”, në kuadër të Bllokut urban “F-5”, Tërësia urbane “F”, të Planit Rregullues “Prishtina Re - Zona Perëndim” në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale, **nr.355 – 2, 5, 6, 7 & 8, 356 - 13 & nr.424 – 41, ZK Çagllavicë**, të pronarëve / poseduesve: “Alb Petrol” sh.p.k. nga Podujeva, Ismajl Hyseni, Idriz Selmani, Etnik dhe Arbër Hajdini nga Prishtina, me Investitor, “ALB Petrol” sh.p.k. nga Podujeva, me ARBK 812050657, dhe me pronar, Idriz Ejupi, sipas projekt propozimit konceptual & Planit të situacionit – “zgjidhja urbane”, si në vijim:

**a) Faza “1”** e realizimit të kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa, “1”** me 2B+S+P+12 (*me aplikim të “Arkitekturë e qëndrueshme”*), në kuadër të Bllokut urban “F-5”, Tërësia urbane “F”, të Planit Rregullues “Prishtina Re - Zona Perëndim” në Prishtinë, do të trajtojë parcelat kadastrale **nr.355-5, 6, 7 & 8 ZK Çagllavicë**, si dhe pjesën e parcelës kadastrale **nr.424–41 ZK Çagllavicë**, me sipërfaqe  $S=123m^2$ , me pronar / posedues “Alb Petrol” sh.p.k. nga Podujeva, përmes transferit, me sipërfaqe totale të tyre,  **$S=1,997m^2$** , nga këto,  **$S=1,831m^2$** , brenda vijës rregulluese-parcelës ndërtimore, dhe  **$S=43+123=166m^2$** , jashtë vijës rregullues – parcelës ndërtimore, bazuar në Plani i situacionit–“zgjidhja urbane”, dhe

**b) Faza “2”** e realizimit të kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa “2”** me - 2B+S+P+10, në kuadër të Bllokut urban “F-5”, Tërësia urbane “F”, të Planit Rregullues “Prishtina Re - Zona Përendim” në Prishtinë, do të trajtojë parcelën **nr.355-2** dhe pjesët e parcelave kadastrale, **nr.355-5 & nr.356-13 ZK Çagllavicë**, me pronarë / posedues privat, me sipërfaqe totale të tyre,  **$S=912m^2$** , nga këto,  **$S=684m^2$** , brenda vijës rregulluese-parcelës ndërtimore, dhe  **$S=228m^2$** , jashtë vijës rregullues – parcelës ndërtimore, bazuar në plani i situacionit–“zgjidhja urbane”.

*Pronarët e parcelave kadastrale të lartcekura me investitorin potencial me kërkesë të veçantë do të aplikojnë për pajisje me kushte ndërtimore duke u bazuar edhe në këtë analizë.*

**V. Kushtet ndërtimore** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar për realizimin / ndërtimin ndërtesës shumë banesore & afariste – **Ndërtesa, “1”** me 2B+S+P+12 (*me aplikim të “Arkitekturë e qëndrueshme”*), në kuadër të Bllokut urban “F-5”, Tërësia urbane “F”, të Planit Rregullues “Prishtina Re - Zona Perëndim” në Prishtinë, përcaktohen duke konsultuar, analizuar, si dhe mbështetur në dokumentet e planifikimit hapësinor, projekt propozimin e prezantuar, gjendjen ekzistuese të lokacionit dhe rregullativën ligjore në fuqi, dhe ato janë:

- Organizimi & qasjet në kompleks, pozicionimi, gabaritet, etazhitetet e ndërtesave, raporti i ndërtesave me vijat rregulluese & ndërtimore, distanca në mes ndërtesave dhe nga kufiri i parcelës ndërtimore, rrugët dhe vend parkingjet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit – “zgjidhja urbane”, të bashkangjitur vendimit kushteve ndërtimore;
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të Bllokut urban “F-5”, Tërësia urbane “F”, të Planit Rregullues “Prishtina Re - Zona Perëndim” në Prishtinë, planifikohet të ndërtohet ndërtesa shumë banesore & afariste, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

## **Kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste - Ndërtesa "1":**

**Ndërtesa: "1" – S=7,395.39m<sup>2</sup> / 4,992.50m<sup>2</sup>, mbi tokë + 2,402.89m<sup>2</sup>, nën tokë /,**

Etazhitet: 2B+S+P+12;

- Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale të trajtuara me sipërfaqe brenda vijës rregulluese - parcelë ndërtimore – Faza "1" (sipas vendimit dhe analizës në paragrafi IV. *Plani i situacionit...*) për realizimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste, janë:

- nr. 355-5; S=373m<sup>2</sup>;

- nr. 355-6; S=490m<sup>2</sup>;

- nr. 355-7; S=486m<sup>2</sup>;

- nr. 355-8; S=482m<sup>2</sup>;

**Totale: S=1,831m<sup>2</sup>**

- nr.424-41; S=0.00m<sup>2</sup>

**Totale: S=1,831m<sup>2</sup>**

- Parcelat dhe pjesët e parcelave të trajtuara me sipërfaqe jashtë vijës rregulluese, për realizimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste, janë:

- nr. 355-5; S=1m<sup>2</sup>;

- nr. 355-6; S=10m<sup>2</sup>;

- nr. 355-7; S=14m<sup>2</sup>;

- nr. 355-8; S=18m<sup>2</sup>;

**Totale: S=43m<sup>2</sup>**

- nr. 424-41; S=123m<sup>2</sup>;

**Totale: S=166m<sup>2</sup>**

- Parcelat dhe pjesët e parcelave të trajtuara me sipërfaqe brenda vijës rregulluese, për trajtim në fazat e ardhshme – Faza "2" (sipas analizës në paragrafi IV. *Plani i situacionit...*), të kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste, janë:

- nr. 355-5; S=126m<sup>2</sup>;

- nr. 355-6; S=0.00m<sup>2</sup>;

- nr. 355-7; S=0.00m<sup>2</sup>;

- nr. 355-8; S=0.00m<sup>2</sup>;

**Totale: S=126m<sup>2</sup>**

- nr. 424-41; S=0.00m<sup>2</sup>;

**Totale: S=126m<sup>2</sup>**

- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës të jetë shumë banesor & afarist (miks), dhe hapësira tjera përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhesh etj. (sipas projekt propozimit konceptual);
- Etazhite maksimal për Blloku urban "F-5", Tërësia urbane "F" të Planit Rregullues "Prishtina Re - Zona Perëndim" në Prishtinë, është min. P+7, max. P+10 etazhe, ndërsa sipas projekt propozimit, duke llogaritur edhe shpronësimin/kompensimin, etazhite maksimal është -2B+S+P+12;
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore / parcelave të bashkuara (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë /gabarit të përdhësës ose suteranit, sipas planit rregullues lejohet max.40%, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:

$S=1,831 \times 0.4=732.40m^2$  / lejuar sipas planit rregullues, për etazhat e para, deri në h=15m, matur në vijën e ndërtimit /;

$S=1,831 \times 0.25=457.75m^2$  / lejuar sipas planit rregullues, për etazhet tjera /;

$S=1,831 \times 0.5=915.50$  / me aplikim të "Arkitekturë e qëndrueshme" /

$S=915.50m^2$  / sipas projekt propozimit konceptual /;

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore / parcelave të bashkuara (ISHPN), për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit, është max.60%, bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr.031–185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:

$S=1,831 \times 0.6=1,098.60m^2$  / lejuar sipas planit rregullues dhe Vendimit të kryetarit /;

$S=1,087.20m^2$  / sipas projekt propozimit konceptual /;

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore / parcelave të bashkuara, për hapësira gjelbëruese (ISHPGJ), bazuar në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01 nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës është min.40%, dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, 0.3 (30 %), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:

- $S=1,831 \times 0.4=732.40m^2$  / lejuar sipas planit rregullues dhe Vendimit të kryetarit /;
- $S=549.30 +184.10=732.40m^2$  / sipas projekt propozimit konceptual, në parter dhe në kulm të gjelbër /;
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Rregullues "Prishtina Re - Zona Përendim" në Prishtinë, për bllokun urban "F-5", është **2.5**.  
Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën  $\pm 0.00$ , 50% për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - **suteren**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe sipas llogarive kjo sipërfaqe është:  
 $S=1,831 \times 2.5=4,577.50m^2$  / lejuar sipas planit rregullues, për pronën private /;  
 $S=4,992.50m^2$  / sipas projekt propozimit, duke llogaritur edhe shpronësimin / kompensimin /;
  - Me aplikimin e Vendimit 14nr.464/01–97987/22 dt.05.05.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kompensimin e pronës private planifikuar për interes publik me sipërfaqe ndërtimore, mund të kompensohen sipërfaqet e parcelave jashtë vijës rregulluese deri në 20% të parcelës ndërtimore (parcelave dhe pjesëve të tyre brenda vijës rregulluese), dhe për pjesët e parcelave kadastrale, me sipërfaqe  $S=166m^2$ , të përfshira jashtë vijës rregulluese, e përcaktuar në përqindje (%), është:  $S=166 / 1,813 \times 100=9.06\%$ . Andaj, bazuar në vendimin e lartcekur, pronarët dhe investitori, do të kompensohen me sipërfaqen ndërtimore, llogaritur me koeficient të ndërtimit, si në vijim:  **$S=166 \times 2.5=415m^2$** ;  
Andaj, sipërfaqja totale ndërtimore mbitokësore e lejuar për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste – **Ndërtesa "1"** me 2B+S+P+12 do të jetë:  **$S=4,577.50 + 415=4,992.50m^2$** .
  - Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, protokoluar me numrin 01nr.031-185481 dt. 14.08.2015, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
  - Bazuar në kriteret e planit rregullues, distanca minimale ballore në mes të ndërtesave të jetë  $1.0 \times H$  (ku H, është lartësia mbi tokë e ndërtesës), kurse e ndërtesës me kufirin e parcelës fqinje  $0.5 \times H$  ose min.  $7.0m'$ , ku distanca prej  $7.0m'$  vlen edhe në rastet kur në atë fasadë nuk ka hapje – ndriçim primar për hapësirat e banimit (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, korridore të banesave, etj). Distanca në mes të ndërtesave (shumë banesore apo afariste) te fasadat e kombinuara (njëra ndërtesë fasadë ballore, kurse tjetra ndërtesë fasadë anësore) është  $0.6 \times H$ ;
  - Ngritja e nivelit të përdhësës nga niveli i terrenit- trotuarit të ndërtesës, lejohet max.  $1.20 m$ ;
  - Kati i fundit i ndërtesave shumëbanesore duhet të tërhiqet brenda vijës ndërtimore për min.  $2.5 m$ ;
  - Në rrugët aktive me përmbajtje të ndryshme afariste, përdhesa preferohet të hyjë brenda vijës ndërtimore për maksimum  $3 m$ , duke krijuar kështu strehë për hapësirën afariste dhe shteg më të gjerë të këmbësorëve;
  - Çdo objekt ndërtimor i planifikuar duhet të jetë i vendosur, me fasadën e përparme në vijën ndërtimore, respektivisht përbrenda hapësirës së kufizuar me vijën ndërtimore;
  - Qasja në Kompleksin me ndërtesa shumë banesore & afariste të jetë nga rrugët e planifikuara të planit rregullues urban dhe rrugët e brendshme e bllokut, sipas Plani i situacionit - "zgjdhja urbane";
  - Për qarkullim më të lehtë të zjarrfikësve duhet të parashihet qasje e brendshme çdo  $50 m'$ , përkatësisht në çdo  $50 m'$  duhet të ekzistojë pasazh apo rrugë, me gjerësi min.  $4.0 m$ ;
  - Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vend-parkimet e jashtme, shtigjet, trotuaret kënde të lojërave për fëmijë, terrene sportive, mobiluar urban, etj.;
  - Për çdo njësi banesore-rezidenciale të planifikohet  $1.0$  (një) vend-parkim, ndërsa për pjesët afariste të ndërtesës, varësisht prej destinimit, të parashihen  $1 VP/30 m^2$  të sipërfaqes së vlefshme të shitjes;
  - Parcelat ndërtimore të ndërtesave shumëbanesore nuk duhet të rrethohen;
  - Në kuadër të kompleksit të planifikohen hapësira-pika për grumbullimin dhe vendosjen e mbeturinave;
  - Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;
  - Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuar në kriteret dhe parametrat urban të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Përendim".

**VI. Ndarja** / parcelimi i parcelave kadastrale **nr.355-5, 6, 7 & 8 ZK Çagllavicë**, si dhe **nr.424-41 ZK Çagllavicë**, do të realizohet bazuar në Plani i situacionit-“zgjdhja urbane”, Situacionin e parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga plani rregullues, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01, dhe manualin e ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami, me licencë nr.12.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - “zgjdhja urbane” dhe “Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01”, punuar nga kjo drejtori dhe manuali i ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami, me licencë nr.12. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas vendimit të kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve, duke u bazuar edhe në Plani i situacionit - “zgjdhja urbane” dhe “Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01”, punuar nga kjo drejtori dhe manualin e ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

**VII. Bashkimi** i parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale, **nr.355-5, 6, 7 & 8 ZK Çagllavicë**, do të realizohet bazuar në Plani i situacionit – “zgjdhja urbane” dhe në manualin e bashkimit, punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami, me licencë nr.12.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e parcelave kadastrale dhe pjesëve të parcelave të lartcekura, në një parcelë ndërtimore bazuar në Plani i situacionit-“zgjdhja urbane” & manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami, me licencë nr.12. Procedura e bashkimit të do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për regjistrimin në regjistrin kadastrale, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e bashkimit të parcelave të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarëve, duke u bazuar në Plani i situacionit -“zgjdhja urbane” dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeodeti i licencuar, të cilat do të jenë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

**VIII. Kompensimi/shpronësimi** i pjesëve të parcelave kadastrale, **nr.355-5**, me  $S=1m^2$ , **nr.355-6** me  $S=10m^2$ , **nr.355-7**, me  $S=14m^2$  & **nr.355-8** me  $S=18m^2$  ZK Çagllavicë, me sipërfaqe totale  $S=43m^2$ , me pronar/posedues Ismajl Hyseni, Idriz Selmani, Etnik dhe Arbër Hajdini nga Prishtina, si dhe pjesës së parcelës kadastrale **nr.424-41**, me  $S=123m^2$  ZK Çagllavicë, me pronar “AlbPetrol” sh.p.k. nga Podujeva, të përfshira në hapësira publike të planifikuara-rrugë të planifikuara, do të realizohet sipas kalkulimeve, si më poshtë:

Sipas kalkulimeve në paragrafin IV., parcela ndërtimore e ndërtesës shumë banesore dhe afariste, në kuadër të Blloku urban “F-5”, është me sipërfaqe prej  **$S=1,831m^2$** , andaj bazuar në Vendimin 14nr.464/01-97987/22 dt.05.05.2022, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, kompensimi i pronës private të përfshirë në hapësirë me interes publik, mund të realizohet me koeficient të ndërtimit për sipërfaqet deri 20%, dhe sipas kësaj, kjo sipërfaqe përcaktuar në përqindje (%) është,  $S=166 / 1,831 \times 100=9.06\%$ . Andaj, bazuar në vendimin e lartcekur, pronarët dhe investitori, do të kompensohen me sipërfaqen ndërtimore, llogaritur me koeficient të ndërtimit, si në vijim:  **$S=166 \times 2.5=415m^2$** .

Procedura e kompensimit / shpronësimit me koeficient ndërtimi, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të bashkëpronarëve të parcelave dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Kompensimi / shpronësimi me sipërfaqe ndërtimore të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë për Pronë të Komunës së Prishtinës, dhe mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga pronarët dhe investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesës shumë banesore dhe afariste, të përcaktuara me këtë vendim të kushteve ndërtimore.

Sipërfaqet definitive të shpronësimit / kompensimit me sipërfaqe ndërtimore të trajtohen pas ndarjes, bashkimit dhe barazimit të sipërfaqeve të parcelave kadastrale, sipas paragrafit IV. të këtij vendimi.

**IX. Kyçja në infrastrukturë** - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

**X. Dokumentacioni ndërtimor** - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, dhe të licencuar, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën V., projekt propozimin e prezantuar, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërti-së Nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor", bazuar në UA Nr.33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri, si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m<sup>2</sup>, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dymëve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiluarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

**XI. Dokumentacioni ndërtimor për Masat e mbrojtëse nga zjarri** të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

*Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:*

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjdhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale –LMK të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

*Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:*

- Raporti për LMK në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;
- Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

**XII. Dokumentacioni ndërtimor** - elaborati për "Arkitektura e qëndrueshëm", i hartuar konform kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 01nr.031 – 185481 dt.14.08.20215, për të cilin është dhënë vlerësimi për rregullsi nga Sektori i Mjedisit dhe i Efiqencës i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, në fazën e caktimit të kushteve ndërtimore, përmes shkresës zyrtare "Vlerësim në arkitekturë të Qëndrueshme", me referencë 05nr.352/10-37578/26 dt.25.03.2026, me rastin e aplikimit për leje ndërtimore, aplikuesi obligohet të sigurojë rregullsinë dhe të sigurojë pëlqim në dokumentacionin ndërtimor – elaboratin për "Arkitektura e qëndrueshëm", i cili duhet të jetë pjesë përbërëse e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor, të përshkruar si në paragrafin XI., të këtij vendimi, i hartuar bazuar në kushtet ndërtimore të përcaktuara me këtë vendim.

*Në rast të mos përmbushjes së kësaj kërkesë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit obligohet të rishikojë vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore, konkretisht përcaktimin e koeficientit të shfrytëzimit të parcelës ndërtimore (nga ISHP 40 + 10%, në ISHP 40%).*

**XIII. Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.43/01–94474/17 dt. 24.04.2017 dhe "Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01-227572/23 dt.01.12.2023, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin / investitorin.

Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelave & investitorit);

**XIV. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore** - meqenëse parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale, nr.355-5, 6, 7 & 8 ZK Prishtinë, që trajtohen me këto kushte ndërtimore, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, janë të evidentuara me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore dhe pyjore, me klasë të kualitetit "Arë i Klasit 5", kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore,

konform nenit 11, 13 & 14 të Ligjit nr. 02/L-26, dhe nenit 8, 9 & 14 të UA i MBPZHR Nr.41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë;

Për ndërrimin e tokës bujqësore dhe pyjore në tokë ndërtimore, në zonat e planifikuara për ndërtim, për inicimin e procedurës për leje ndërtimore, kërkohet paraprakisht ndërrimi i destinimit të tokës pyjore në tokë ndërtimore për parcelat e parapara për ndërtim dhe ato për infrastrukturë, konform dispozitave ligjore të Ligjit mbi Tokën Bujqësore, nr. 02/L-26, dt. 24.06.2005 dhe UA Nr. 41/2006 dt. 27.12.2006, që rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore përcaktuar sipas Plani i situacionit – “zgjdhja urbane” dhe manualit të bashkimit dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, me sipërfaqe totale: **S=1,831m<sup>2</sup>** dhe këto toka do të regjistrohen si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, pas ndarjes së kësaj parcele dhe në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

**XV. PAGESA** e taksës administrative për leje ndërtimi dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të kalkulohet/realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01nr.434/01–94474/17 dt.24.04.2017 dhe “Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01nr.434/01-227572/23 dt.01.12.2023, dhe dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. PAGESA e taksës & tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

PAGESA e taksës administrative do të llogaritet edhe për leje rrënimi për rrënimin e ndërtesave ekzistuese në kuadër të parcelave kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënitit, aplikuar me kërkesë të veçantë;

**XVI. Kushti realizimit të Ndërtesa “2”** (si Faza “2”), bazuar në analizën si në paragrafin IV. është arritja e marrveshjes për bashkëinvestim me pronarin e parcelës kadastrale **nr.355-2 ZK Çagllavicë**, si dhe me pronarët e pjesëve të parcelave kadastrale, **nr.356- 13 ZK Çagllavicë**;

**XVII. Vlefshmëria** e vendimit të kushteve ndërtimore është një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

## A r s y e t i m

Kërkuesit: Pronarët, Ismajl Hyseni, Idriz Selmani, Etnik dhe Arbër Hajdini nga Prishtina dhe “Alb Petrol” sh.p.k. nga Podujeva, me Investitor “Alb Petrol” sh.p.k. nga Podujeva, rr. “Halil Breznica”, pn, në Podujevë, me ARBK 812050657, dhe me pronar / përfaqësues Idriz Ejupi nga Podujeva, me kërkesën 05nr.350/02-147747/25 dt.26.09.2025 (sipas eLeja KKN–611), kanë kërkuar nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste – **Ndërtesa, “1”** me 2B+S+P+12 (**me aplikim të “Arkitekturë e qëndrueshme”**), në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën për kushte ndërtimore 05nr.350/02-147747/25 dt.26.09.2025 (sipas eLeja KKN– 611), kërkesën për informim 05nr.035/01–167828/25 dt.04.11.2025, të subjektit juridik “Dino”sh.p.k. nga Lipjani, dhe kërkesës për plotësim dokumentacioni 05nr.070/01-32765/26 dt.04.03.2026, si dhe gjatë fazës së trajtimit është prezantuar dhe trajtuar ky dokumentacion:

- *Dëshmia mbi pronësinë - kopja e planit dhe certifikata e njësisë kadastrale për parcelën kadastrale nr.355 - 5, 6, 7 & 8; nr.424 – 41 ZK Çagllavicë, lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit;*
- *Projekti konceptual - "zgjdhja urbane" e ndërtesës shumë banesore & afariste – Ndërtesa “1”, me 2B+S+P+12, hartuar nga kompania projektuese “LSN + Partners” shpk nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit 811425067, dhe me projektues: Sado Kolic, msc. ark;*



- Manuali gjeodezik "Situacioni i gjendjes faktike nr. parcelës: nr.355 - 5, 6, 7 & 8 ZK Çagllavicë, punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami me licencë nr.12;
- Manuali gjeodezik "Propozim për ndarje të parcelës sipas Planit Rregullues-Prishtina e Re", i punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami me licencë nr.12;
- Shkresa "Njoftimi publik", e datës 28.10.2025 deri me 11.11.2025, lëshuar nga kjo drejtori;
- Fotot e lokacionit me shkresën "Njoftim publik";
- Shkresa "Mendimi nga faza e Komunikacionit", i datës 18.03.2026, lëshuar nga zyrtari përgjegjës i drejtorisë;
- Akti "Pëlqim për fqinjësi të përbashkët dhe ndërtim në kufi pronësor" të datës 02.02.2026, e nënshkruar nga subjekti juridik "Alb Petrol" sh.p.k. nga Podujeva dhe "Dino" sh.p.k. nga Lipjani, i vërtetuar te Notere Valbona Y. Murtezi Bytyqi në Prishtinë, me LRP.255/2026, dt.04.02.2026;
- Akti noterial "Kontratë për ndërtim e përbashkët të objektit banesor-afarist" e lidhur në mes të pronarëve Ismajl Hyeni, dhe Zylfie Hyseni nga Podujeva, dhe investitorit "Alb Petrol"sh.p.k. nga Prishtina, vërtetuar te noteri Shkelzen I.Ademi në Prishtinë, me LRP.nr. 4278/2025, Ref.nr.1398/2025, dt. 25.08.2025 (ekstrakt nga origjinali);
- Akti noterial "Kontratë për ndërtim e përbashkët të objektit banesor-afarist" e lidhur në mes të pronarëve Etnik Hajdini, dhe Arbër Hajdini nga Prishtina, dhe investitorit "Alb Petrol"sh.p.k. nga Prishtina, vërtetuar te noteri Shkelzen I.Ademi në Prishtinë, me LRP.nr. 3997/2025, Ref.nr.1301/2025, dt. 18.08.2025 (ekstrakt nga origjinali);
- Akti noterial "Kontratë për ndërtim e përbashkët të objektit banesor-afarist" e lidhur në mes të pronarit Idriz Selmani nga Gjilani, dhe investitorit "Alb Petrol"sh.p.k. nga Prishtina, vërtetuar te noteri Shkelzen I.Ademi në Prishtinë, me LRP.nr. 3999/2025, Ref.nr.1302/2025, dt. 18.08.2025 (ekstrakt nga origjinali);
- Fotokopja e certifikatës së biznesit të "Alb Petrol" sh.p.k. nga Podujeva, me ARBK 812050657;
- Fotokopja e aktit noterial "Autorizim gjeneral", dhenë nga subjekti juridik "Dino" shpk nga Lipjani, për Lulzim Sllamniku, jurist, për përfaqësim, i përpiluar dhe noterizuar te Noter Fatmir Tasholli në Lipjan, me LRP.nr.4967/2024, dt. 24.05.2024;
- Fotokopja e certifikatës së biznesit të "Dino" sh.p.k. nga Lipjani, me ARBK 811272343;
- Shkresa "Pëlqim për Arkitekturës së Qëndrueshme", 05nr.352/10 – 37578/26 dt.01.04.2026, lëshuar nga Sektori i Mjedisit dhe Efiçencës i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit;
- Fotokopja e dokumentit të identifikimit të pronarëve, të investitorëve dhe të autorizuarëve;
- Fotot e lokacionit.

Drejtorja e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, pas pranimit të kërkesës për caktimin e kushteve ndërtimore, 05nr.350/02-147747/25 dt.26.09.2025 (sipas eLeja KKN – 611), dhe plotësuar me shkresën 05nr.070/01–32765/26 dt.04.03.2026, si dhe shkresës "Kërkesë për informim" 05nr.035/01–167828/25 dt.04.11.2025, shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për atë zonë – Plani Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim", si dhe rregullativën ligjore në fuqi, nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, dokumenteve të prezantuara gjatë fazës së trajtimit të kërkesës administrative, si dhe projekt propozimit – projektit konceptual me "zgjidhja urbane" & projektit ideor të prezantuar, në mënyrë kronologjike konstatoi se:

Kjo drejtori, ka pranuar kërkesën 05nr.350/02-147747/25 dt.26.09.2025 (sipas eLeja KKN – 611), në emër të kërkuësve: Pronarëve, Ismajl Hyseni, Idriz Selmani, Etnik dhe Arbër Hajdini nga Prishtina dhe "Alb Petrol" sh.p.k. nga Podujeva, me Investitor "Alb Petrol" sh.p.k. nga Podujeva, rr. "Halil Breznica", pn, në Podujevë, me ARBK 812050657, dhe me pronar / përfaqësues Idriz Ejupi nga Podujeva, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste – **Ndërtesa, "1"** me 2B+S+P+12 (**me aplikim të "Arkitekturë e qëndrueshme"**), në kuadër të Bllokut urban "F-5", Tërësia urbane "F", të Planit Rregullues "Prishtina Re-Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale, **nr.355-5, 6, 7 & 8 ZK Çagllavicë**, si dhe me trajtim përmes transferit të pjesës së parcelës kadastrale **nr.424-41 ZK Çagllavicë**, me pronar / posedues "Alb Petrol" sh.p.k. nga Podujeva, duke prezantuar planin e situacionit dhe zgjidhjen urbane.

Andaj, paraprakisht, pas pranimit të kërkesës për kushte ndërtimore, në fazën fillestare të shqyrtimit të saj, në mbështetje të rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 18 të Ligjit të Ndërtimit Nr. 04/L-110 dt.31.05.2012, nëniti 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, ka vendosur "Njoftimi publik", me datë 28.10.2025, i cila ka qëndruar gjerë me datë 11.11.2025, ku sipas rregullativës ligjore të lartcekur, para caktimit të kushteve ndërtimore, publiku i rrethinës duhet të informohet me synimin e kërkuësve dhe ofrimin e mundësisë për dhënien e komenteve pronarëve / poseduesve të rrethinës në diametrin

e dritës prej 50m'. Gjatë kësaj periudhe kohore, në postën elektronike zyrtare nuk ka arritur asnjë koment, vërejtje apo sugjerim, përveq kërkesës 05nr.035/01-167828/25 dt.04.11.2025, të parashtruar nga Subjekti juridik "Dino" sh.p.k. nga Lipjani, përmes së cilës ka kërkuar nga kjo drejtori, qasje në dokumentacion zyrtar, përkatësisht në kërkesën për leje ndërtimore dhe caktimin e kritereve për ndërtim, në dokumentacionin ndërtimor, të propozuar, në vlerësimet dhe opinionete e dhëna nga drejtoritë tjeram dhe çdo dokument tjetër shoqërues, lidhur me këtë procedurë të shqyrtimit. Kërkesa e njëjtë është shqyrtuar në këtë drejtori, dhe kërkuesi/subjekti juridik në fjalë, është njoftuar dhe ka marrë informacionet e kërkuara, dhe i njëjti është pajtuar me procedimin e kërkesës për caktim të kushteve ndërtimore, për subjektin juridik "Alb Petrol" sh.p.k. nga Podujeva, bazuar në pëlqimin e dhënë, sipas aktit të përshkruar si më poshtë.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të projekt propozimit konceptual me Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", të prezantuar me kërkesën për caktim të kushteve ndërtimore, 05nr.350/02-147747/25 dt.26.09.2025 (sipas eLeja KKN-611), dhe krahasimit të tij, në raport me planin rregullues, kjo drejtori ka konstatuar se brenda parcelave ndërtimore-riparcelimit, të Bllokut urban "F-5", përfshihen edhe parcelat kadastrale nr **nr.355-11**, 21, **nr.356-13** & **nr.355-2** ZK Çagllavicë, dhe më pas, ka kërkuar nga aplikuesit, që ti analizojë, dhe mundësisht, të njëjtat ti trajtojë në kuadër të propozim zgjidhjes urbane, të prezantuar. Lidhur me këtë, fillimisht, aplikuesit kanë prezantuar aktin "Pëlqim për fqinjësi të përbashkët dhe ndërtim në kufi pronësor" të datës 02.02.2026, nënshkruar nga subjektet juridike "Dino" sh.p.k. me pronar Abedin Salihu, pronar dhe bartës i të drejtave reale mbi parcelat kadastrale **nr. 355-11** & 21; **nr.2036-0**; **nr.356-7**, 8 & 17 ZK Çagllavicë, dhe "ALB Petrol" sh.p.k. nga Podujeva, me pronar Idriz Ejupi, pronar dhe bartës i të drejtave reale mbi parcelat kadastrale nr. 355-5, 355-6, 355-7, 355-8 ZK Çagllavicë, i vërtetuar te Notere Valbona Y. Murtezi Bytyqi me LRP. 255/2026, përmes të cilit subjektet në fjalë, kanë arritur pajtueshmëri të plotë për ndërtimin e ndërtesave, në përputhje me kriteret e Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim", sipas skicës së bashkëngjitur aktit të njëjtë. Ndërsa, më pas, duke konstatuar se, pronari i parcelës kadastrale nr. 356-13 ZK Çagllavicë, nuk është paraqitur në periudhën kohore të qëndrimit të njoftimit publik, dhe se e njëjta parcelë kadastrale mund të trajtohet edhe me pjesën tjetër të bllokut urban, dhe meqenëse, poseduesi i parcelës kadastrale nr. 356-2 ZK Çagllavicë, nuk e ka të rregulluar çështjen pronësore, ka vazhduar procedurën për shqyrtimin dhe vendosjen për kërkesën në trajtim.

Pas zhvillimit të këtyre procedurave, dhe shqyrtimit dhe analizimit, të mëtejme, të projekt propozimit konceptual me Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", konstatohet se propozim zgjidhja urbane, në kuadër të së cilës janë përfshirë në trajtim parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale **nr.355-5**, 6, 7 & 8 & **nr.424** – 41 ZK Çagllavicë, dhe parcelat kadastrale **nr.355-2**, **nr.355-5** & **nr.356-13** ZK Çagllavicë, është konceptuar të zhvillohet në dy grupe të realizimit: Faza "1", & Faza "2", në kuadër të Parcelës ndërtimore të në kuadër të Bllokut urban "F-5", Tërësia urbane "F", të Planit Rregullues "Prishtina Re - Zona Perëndim" në Prishtinë, me trajtim të parcelave kadastrale **nr.355-5**, 6, 7 & 8 & **nr.424** – 41 ZK Çagllavicë (Faza "1"), dhe me analizë urb-arkitektonike të parcelave kadastrale **nr.355-2**, **nr.355-5** & **nr.356-13** ZK Çagllavicë (Faza "2"), konkretisht sipas përshkrimit në paragrafin **IV. Plani i situacionit**, të dispozitivit të këtij vendimi të kushteve ndërtimore.

Sipas propozim zgjidhjes urbane, të prezantuar, është planifikuar, që parcela kadastrale nr. **nr.424**–41 ZK Çagllavicë, me S=123m<sup>2</sup>, në pronësi të subjektit juridik "Alb Petrol" shpk, e shtrirë në hapësirë të planifikuar me destinim publik-rrugë të planifikuar të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim", të trajtohet përmes kompensimi/shpronësimit, dhe e drejta ndërtimore e saj, të transferohet brenda parcelës ndërtimore të bllokut urban "F-5", të planit të njëjtë, dhe pjesët e parcelave kadastrale nr. 355-5, 6, 7 dhe 8 ZK Çagllavicë, të shtrira jashtë vijës rregulluese të bllokut urban "F-5", është propozuar, poashtu, të trajtohen përmes shpronësimit/kompensimit me koeficient të ndërtimit, sipas mënyrës dhe procedurës së përshkruar në pikën VIII., të këtij vendimi, në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës. Ndërsa, pjesa tjetër, e parcelës kadastrale nr. 355-5 ZK Çagllavicë, me S=126m<sup>2</sup>, mbetet të trajtohet në fazat tjera të zhvillimi.

Bazuar në projekt propozimin konceptual të prezantuar është konstatuar se shfrytëzimi i parcelës ndërtimore ISHP-ja, (parcela kadastrale brenda vijave rregulluese), është propozuar dhe më pas është miratuar, 40 + 10%, bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01nr.031 – 185481 dt.14.08.20215, dhe për këtë aplikuesi obligohet, që me rastin e aplikimit për leje ndërtimore, të prezantojë elaboratin për "Arkitektura e qëndrueshme", të hartuar bazuar në kushtet ndërtimore të përcaktuara me këtë vendim, dhe në kriteret e përcaktuara me Vendimin e Kryetarit të Komunës së

Prishtinës, 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, dhe sipas pëlqimit të dhënë përmes shkresës zyrtare “Pëlqim për Arkitekturë të Qëndrueshme”, me referencë 05nr.352/10–37578/26 dt.01.04.2026, lëshuar nga Sektori i Mjedisit dhe i Efiqencës i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, sipas përshkrimit në paragrafin XII., të këtij vendimi;

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, është konstatuar rregullësia e Planit të situacionit – “zgjidhja urbane” dhe janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kycje në ndërtesë me rrugën e planifikuar të planit rregullues si dhe e njëjtat me rrugët tjera të planit, ku ndër të tjera konstatohet:

*“Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të “ALB Petrol” shpk., në lagjen “Prishtina e re, Zona Perëndim”, në Prishtinë, lidhur me kërkesën për kushteve ndërtimore të lëndës 05nr.350/02-147747/25 dt.26.09.2025, kyçja për automjete në rrugëm “Riçard Holbruk” e cila rrugë është e parapare edhe me Planin Rregullues “Prishtina e Re Zona Perëndim” në Prishtinë, për ndërtesën me etazhitet 2B+S+P+12, sipas zgjidhjes së prezantuar mund të pranohet si e till, marrë parasysh hapësirën e kësaj zgjidhje urbane në raport me rrugën e planifikuar. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesave banesore me afarizëm për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas “Rregullores për Normat Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi”, “Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të Komunës së Prishtinës” dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes. Gjerësia e rrugëve kaluese me qarkullim dy kahor përgjatë hapësirave të vend parkimeve të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m. Kyçja duhet të harmonizohet dhe të përshtatet me profilin e rrugës së planifikuar dhe në kohën kur realizohet ajo sipas planit. Kyçja si e tillë është paraparë në rrugë kryesore tre shiritore, andaj në mungesë të rrugëve të kategorive me te ulëta si ato dy shiritore, dhe me qëllim të shmangies së kyçjeve të shpeshta, rritjen e sigurisë dhe ruajtjen e funksionit të rrugëve tre shiritore, kjo kyçje do të shërbejë edhe për parcelat fqinje në fazat e ardhshme të implementimit të zgjidhjeve urbane përgjatë kësaj rruge kyçëse dhe si e tillë nuk duhet të jetë pengesë për përdorim të përbashkët të kësaj kyçje”.*

Andaj, si konkludim përfundimtar, bazuar në konstatimet e lartshënuara, dhe në shqyrtimin e dokumentacionit të prezantuar, pas konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, konkretisht nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt.31.05.2012, nenit 13 të Udhëzimit Administrati të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve, si dhe diskrecionin për vendosje të çështjeve të planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe në bazë të nenit 21 dhe 44 të LPPA-së Nr.05/L - 031, lidhur me ligjshmërinë për caktimin e kushteve ndërtimore, Drejtorja e Urbanizmit dhe Mjedisit, vendosi që ta miratojë kërkesën për caktimin e kushteve ndërtimore, me faktet – provat e prezantuara, ta trajtojë sipas rregullativës ligjore në fuqi, me ç`rast konstatoi se kërkuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se projekt propozimi me planin e situacionit - “zgjidhja urbane” të prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për miratimin e kërkesës, 05nr.350/02-147747/25 dt.26.09.2025 (sipas eLeja KKN – 611), në emër të kërkuesve: Pronarëve, Ismajl Hyseni, Idriz Selmani, Etnik dhe Arbër Hajdini nga Prishtina, dhe “Alb Petrol” sh.p.k. nga Podujeva, me Investitor “Alb Petrol” sh.p.k. nga Podujeva, rr. “Halil Breznica”, pn, në Podujevë, me ARBK 812050657, dhe me pronar / përfaqësues Idriz Ejupi nga Podujeva, dhe të caktojë kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste – **Ndërtesa “1” me 2B+S+P+12 (me aplikim të “Arkitekturë e qëndrueshme”)**, në kuadër të Bllokut urban “F-5”, Tërësia urbane “F”, të Planit Rregullues “Prishtina Re -Zona Perëndim” në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale, **nr.355-5, 6, 7 & 8 ZK Çagllavicë**, si dhe me trajtim përmes transferit të parcelës kadastrale **nr.424–41 ZK Çagllavicë**, sipas projekt propozimit konceptual – “zgjidhja urbane” të prezantuar dhe miratuar nga kjo drejtori.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

**Shtojcë:** Plani i situacioni - “zgjidhja urbane”, me ndërtesë shumë banesore & afariste – **Ndërtesa, “1” me 2B+S+P+12 (me aplikim të “Arkitekturë e qëndrueshme”)**, në kuadër të Bllokut urban “F-5”, Tërësia urbane “F”, të Planit Rregullues “Prishtina Re - Zona Perëndim” në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale, **nr.355-5, 6, 7 & 8 ZK Çagllavicë**, si dhe me trajtim përmes transferit të parcelës

kadastrale nr.424–41 ZK Çagllavicë, Situacioni i parcelave kadastrale në raport me rrugën e planifikuar, si dhe vijën ndërtimore & rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF 01 dhe Manuali i ndarjes, i bashkimit dhe i shpronësimit të parcelave kadastrale të trajtuara;

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPHI-së;

**I dërgohet:** Kërkuesve/investitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05nr.350/02-147747/25 dt.26.09.2025 (sipas eLeja KKN – 611);

**I dërgohet përmes postës elektronike:** Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, dhe Drejtorisë për Planifikim Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISI E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05NR.350/02 - 147747/25 DT.02.04.2026,**

Zyrtari:  
Ergyn Hajredini

Udhëheqëse e Sektorit:  
Nazife Krasniqi.






Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE  
RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN  
KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:  
Kushtrim Domaneku

Prishtinë: 25.03.2026

Legjenda:

- Vija Rregulluese sipas PRRU
- Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Parcelat kadastrale





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/ Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/ Ministry of Infrastructure and Environment  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtine


Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 355-5, 355-6  
355-7, 355-8

Zona kadastrale / Katastarska zona: Çagllavicë

Numri i lëndës / Broj predmeta: \_\_\_\_\_

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 500



Rilevoi / Snimio: Festim Islami  
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanist/ imo i prezime geodeta/ kompanije)

Aprovoi / Usvojio: \_\_\_\_\_  
(emri dhe mbiemri i përsorit zyrtar/ imo i prezime sluzbenog lica)

Nr. i licencës / Br. licence: 12

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Data e aprovimit / Datum usvajanja: \_\_\_\_\_

Data e rilevimit / Datum snimanja: 04.03.2026









Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/Ministry of Infrastructure and Environment  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtine

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice :424-41


Zona kadastrale / Katastarska zona: Çagllavicë

Numri i lëndës / Broj predmeta: \_\_\_\_\_

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 250

Propozim për ndarje të parcelës sipas Planit Rregullues - Prishtina e Re



Koordinatat e propozimit për ndarje sipas planit

Koordinatat e pikave		
Nr.	Y	X
1	7512937.946	4721410.917
2	7512931.358	4721414.182
3	7512930.402	4721414.823
4	7512929.542	4721415.854
5	7512929.004	4721417.227
6	7512928.946	4721418.677
7	7512929.661	4721422.102

Rilevoi / Snimio: Festim Islami  
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Aprovoi / Usvojio: \_\_\_\_\_  
(emri dhe mbiemri i përsorit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nr. i licencës / Br. licence: 12

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_


Data e aprovimit / Datum usvajanja: \_\_\_\_\_

Data e rilevimit / Datum snimanja: 04.03.2026





Nr.Rev.	Shënimet e revizionit	Data	Nënshkrimi	Kontrolluar
Rev.No	Revision note	Date	Signature	Checked



**Legjenda :**

- Vija e Parcelës
- Vija Rregullative
- Vija Ndërtimore
- Parkingjet
- Parkingjet per atarizëm
- Parkingjet per banim
- Gjelbrimi
- Dru Bleri (Tilia)
- Shkurre (Boxus Micropylla)

Sipërfaqet e projektuara  
 Sip. mbi tokë : 4975.26 m<sup>2</sup>  
 Sip. nën tokë : 2402.89 m<sup>2</sup>  
 Sip. total ndërtimore : 7378.15 m<sup>2</sup>

**LSN+Partners**

Projekt / Project: Objekti Afaristo Banesor		Investitorë/ Investor: "ALB Petrol" sh.p.k.	
Zgjidhja URBANE & PROJEKTI IDEOR/ Conceptual Project		Site/Country: Rep. e Kosovës / Prishtinë Kodi postar / Postal code: 10000	
Projektor/ design by: Florian SHALA, ark. Valesa JAHMURATAJ, Msc.cand. ark. Ermonda GASHAJ, Msc. ark. Eza HJERKEZI, ark. Rina GURI AHMETI, Msc.cand. ark. Vicar BACAJ, Msc.cand. ark.		Adresa e ndërtimit/ Building address: Prishtina e re - Zona Perandrim - Blloku urban - F.S - Prishtinë	
Emertimi/ Name: Situacioni gjerë		Kontrolluar/ Checked by: Lulzim NUZA, FA ark. Sado KOLIC, Msc. ark.	
Fleta/ Page: A/01		Shkalla e vizatimit / Scale: 1:250	
Data/ Date: 3/17/2026		Faza/ Phase: ARKITEKTURA	
Shënime: Ky projekt është prurë dhe korrigjues dhe është i lidhur me projektet tjeter dhe është i njëjti me kompaninë.			

